



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 prill 2021
Nr.ref.:RK 1753/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI175/20

Parashtrues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
AC-II-15-0042, të 21 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Bekim Sejdiu, gjyqtar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesja e kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Parashtruesja e kërkesës), e cila përfaqësohet nga Naser Krasniqi, zyrtar i lartë ligjor tek parashtruesja e kërkesës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, AC-II-15-0042, të 21 korrikut 2020 (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DhPGjS-së), për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, AC-II-15-0042, të 21 korrikut 2020, me të cilin parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të saj të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], 103 [Organizimi dhe Juridiksioni i Gjykatave], 121 [Prona] dhe 159 [Pronat dhe Ndërmarrjet në Pronësi Shoqërore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).
4. Për me tepër, parashtruesja e kërkesës kërkoi, “...në këtë çështje të caktohet seancë dëgjimore për të vetmin qëllim të sqarimit të kërkesës edhe më detajisht dhe prezantimin e opinionëve të disa Gjyqtarëve të kësaj gjykate lidhur me objektin e shqyrtimit të kërkesës së AKP-së, me nr. KI175/20”.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], në lidhje me nenin 21.4 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 17 nëntor 2020, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (anëtarë).
8. Më 20 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Gjithashtu, nga një kopje e kërkesës iu dërgua Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së dhe palëve të tjera në procedurë.

9. Më 5 shkurt 2021, Ismail dhe Shpëtim Telaku (paditësit) dorëzuan në Gjykatë komentet e tyre ndaj pretendimeve të parashtrueses së kërkesës dhe kërkuan refuzimin e kërkesës.
10. Më 5 shkurt 2021, parashtruesja e kërkesës, nëpërmjet shkresës nr. 337 kërkoj mbajtjen e seancës dëgjimore.
11. Më 26 mars 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

Historiku

12. Kërkesa bën fjalë për një kontest pronësor (paluajtshmëri) të iniciuar nga Ismail dhe Shpëtim Telaku, nga Banja e Malishevës, kundër ish-OPB, tani NB Mirusha-Malishevë (e paditura e parë) dhe Komunës së Malishevës (e paditura e dytë). Objekt kontesti në këtë rast është ngastra kadastrale me nr. 55, e evidentuar në librat kadastral me nr. 187 ZK-Banjë, komuna e Malishevës. Paluajtshmëria në fjalë para vitit 1952 evidentohet me nr. 454/1, në vendin e quajtur "Dubrava", me kulturë mal i klasit të IV, në sipërfaqe prej 40.00,00 hektarë dhe pas vitit 1952 evidentohet në emër të NB "Mirusha" me nr. 2/2, 4, 12, 13, 45, 50 dhe 55, me kulturë arë e klasit të IV.

Procedura gjyqësore

13. Më 31 tetor 2007, Gjykata Themelore në Malishevë, duke vendosur sipas padisë së ushtruar nga Ismail dhe Shpëtim Telaku, kundër NB Mirusha-Malishevë dhe Komunës së Malishevës, nxori Aktgjykimin C. nr. 29/2007, përmes të cilit u njohu paditësve të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese. Me këtë vendim, Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi e Komunës së Malishevës, u detyrua që sipërfaqen e lartcekur të paluajtshmërisë ta regjistrojë në emër të paditësve, dhe që të paditurat t'ua njohin paditësve të drejtën e pronësisë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.
14. Brenda afatit ligjor, NB Mirusha-Malishevë, kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, kundër Aktgjykimit [C. nr. 29/2007] të Gjykatës Komunale në Malishevë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës civile, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i atakuar të priset dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.
15. Më 7 prill 2008, Gjykata e Qarkut në Prizren, nxori Aktgjykimin Ac. nr. 571/2007, me të cilin u refuzua ankesa e NB Mirusha-Malishevë dhe u vërtetua Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007, i 31 tetorit 2007, i cili nga kjo datë mori formën e prerë dhe u bë i plotfuqishëm.

Procedura e përmbarimit

16. Më 30 prill 2008, paditësit në Gjykatën Komunale në Malishevë parashtuan propozim për ekzekutimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007, të 31 nëntorit 2007.
17. Më 5 korrik 2012, Gjykata Komunale në Malishevë, lidhur me përmbarimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007, të 31 nëntorit 2007, shpallet inkompetente në pikëpamje lëndore, përkritazi me çështjen juridike të propozuar nga kreditorët Ismajl dhe Shpëtim Telaku, ndaj debitorit NB Mirusha-Malishevë. Sipas shkresave të lëndës, kuptohet se më pas lënda është dërguar në DhPGjS, e evidentuar si C-III-12-1340 dhe e njëjta është ende lëndë aktive.

Procedura në DhPGjS

18. Më 23 maj 2008, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM), në emër të ndërmarrjes NB Mirusha-Malishevë, parashtroi ankesë në DhPGjS, duke kërkuar prishjen dhe anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 571/2007, për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale dhe zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit të procedurës kontestimore.
19. Më 11 shtator 2009, parashtruesja e kërkesës, si suksesore e AKM-së, në emër të NB Mirusha-Malishevë, parashtroi një ankesë tjetër në Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së, përmes së cilës kërkoj po ashtu anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 571/2007, duke kërkuar aprovimin e ankesës, me arsyetimin se ndërmarrja shoqërore në fjalë gjendej në fazën e privatizimit, dhe se gjykatat e rregullta nuk kanë pasur juridiksion për të vendosur në lidhje me këtë çështje juridike.
20. Më 7 gusht 2012, paditësit Ismajl dhe Shpëtim Telaku, parashtuan përgjigje në DhPGjS, duke theksuar se Gjykata Komunale në Malishevë, ka vepruar në kuadër të kompetencave të veta dhe se kjo dëshmohet edhe me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, e cila ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Paditësit, tutje theksuan se tashmë vendimi është i formës së prerë dhe Ligji i DhPGjS-së, i 1 janarit 2012, nuk ka efekt retroaktiv, andaj ankesa e AKP-së duhet të refuzohet si e pabazuar.
21. Më 3 dhjetor 2015, gjyqtarja raportuese e DhPGjS-së, pas shqyrtimit të ankesës SCA-08-0064, të parashtruar nga AKM-ja dhe parashtruesja e kërkesës, lëshon një Urdhër për Zyrën e Regjistrimit, nëpërmjet të cilit kërkon që lënda të evidentohet për Kolegjin e Apelit të DhPGjS-së si AC-II-15-0042.
22. Më 9 dhjetor 2016, parashtruesja e kërkesës dorëzon kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së paditësve Ismajl dhe Shpëtim Telaku, me propozim që padia e paditëseve të refuzohet si e pabazuar në ligj.

23. Më 21 tetor 2020, Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, me Aktvendimin AC-II-15-0042, e hodhi poshtë, si të papranueshme, ankesën e ushtruar nga AKM-ja dhe parashtresja e kërkesës (AKP), kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007, të 31 tetorit 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 571/07, të 7 prillit 2008.

24. Pjesë relevante nga arsyetimi i Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DhPGJS-së:

a) *Arsyetimi përkitazi me zbatimin e dispozitave përkatëse të ligjeve të aplikueshme*

“Ankesa e AKP-së me të cilën kërkon anulimin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007 të datës 31 tetor 2007 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, Ac. nr. 571/07 të datës 07 prill 2008, nuk është e pranueshme, sepse që të dyja aktgjykimet janë të formës së prerë dhe detyruese.

Aktgjykimet apo aktvendimet e formës së prerë sipas ligjit në fuqi, mund të atakohen vetëm me mjete të jashtëzakonshme juridike të goditjes. Në rastin konkret, ankesa e AKM-së-AKP-së nuk mund të interpretohet si çfarëdo mjeti i jashtëzakonshëm i pranueshëm, në bazë të përmbajtjes së saj, pasi që nuk ka përmbajtje të duhur që kërkojnë për një mjet të tillë të goditjes.

Kjo ankesë nuk mund të trajtohet si kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse një kërkesë të tillë, sipas ligjeve në fuqi, mund ta ngritë vetëm Prokurori i Shtetit (Neni 245 i LPK-së).

Kjo ankesë nuk mund të konsiderohet kërkesë për rihapje të procedurave në mungesë të bazës së paraparë me nenin 232 të LPK-së. Në fund, parashtresa/ankesa e AKP-së nuk mund të konsiderohet si revizion me çfarëdo mundësie për të pasur sukses për shkak se nuk janë dhënë bazat e cekura në nenin 214.4 në lidhje me nenin 194 dhe 182 të LPK-së.”

b) *Arsyetimi përkitazi me pretendimin e mungesës së juridiksionit lëndor të gjykatave të rregullta*

“Përkundër faktit se AKP-ja, në ankesën e vet para DHPGJS-së e ka ngritur çështjen e mungesës së juridiksionit të gjykatave të rregullta për nxjerrjen e aktgjykimeve të ankimuara, kur objekti i kontestit përfshihet në juridiksionin e DHPGJS-së (neni 4), dhe palë e paditur është Ndërmarrja Shoqërore (neni 5). Kolegji i Apelit vlerëson se neni 4.4 i Ligjit për Dhomën e Posaçme (LDHP-së) i cili ka hyrë në fuqi me 01.01.2012, nuk ka efekte retroaktive ndaj aktgjykimeve apo aktvendimeve të plotfuqishme të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Kjo situatë ligjore e cekur, ngjashëm është rregulluar edhe me nenin 5.4 të LDHP-së, nr. 06/L-086, i cili ligj tashmë është në zbatim. Rasti në fjalë është i tillë. Prandaj si është vendosur tani më, nga jurisprudenca e

Kolegjit të Apelit (AC-II-14-0015) këtë ankesë duhet hedhur poshtë si të papranueshme.

Aktgjykimet dhe aktvendimet e formës së prerë të nxjerra para hyrjes në fuqi të nenit 4.5.1. të LDHP-së, të vitit 2012, nuk duhet të konsiderohen nule dhe pa efekte juridike, edhe nëse janë nxjerrë për rastet që bien në kompetencë të Dhomës së Posaçme. Zgjidhje të njëjtë parasheh edhe Ligji i ri nr. 06/L-086 në zbatim nga datat 17 korrik 2019.”

c) Arsyetimi përkitazi me parimin res judicata

“Lidhur me pyetjen e vendimeve të nxjerra nga gjykatat kompetente, sistemet ligjore në përgjithësi përgjigjen duke u thirrur në parimin e sigurisë ligjore me vërtetim të plotfuqishmërisë së Aktgjykimit (“res judicata”), që mbulon dhe rregullon të gjitha format e parregullsive të shkaktuara si pasojë e mungesës së juridiksionit.

Edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka inkorporuar këtë arsyetim në koncept të së drejtës për gjykim të drejtë. Në aktgjykimin e rastit XHERAJ v. ALBANIA (Kërkesa nr. 37959), të datës 29.07.2008, thuhet si në vijim: “Gjykata rithekson se në përputhje me preambulën e Konventës, sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët e Shteteve Kontraktuese, një nga aspektet themelore e së cilës është parimi i sigurisë juridike, që ndër të tjerash kërkon se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, aktvendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih Brumarescu v. Rumania [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999 VII).”

d) Arsyetimi përkitazi me pretendimin e mospjesëmarrjes së parashtrueses së kërkesës në procedurë para gjykatave të rregullta

“Megjithatë Kolegji i Apelit ka vërejtur se në procedurat para Gjykatës Komunale në Malishevë, NSH-ja është paraqitur në procedurë dhe e ka parashtruar ankesën ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Malishevë, C. nr. 29/2007 të datës 31 tetor 2007, e cila ankesë ishte refuzuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren me Aktgjykimin Ac. nr. 571/07 të datës 07 prill 2008, dhe ishte vërtetuar Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Malishevë.

Ky rezultat i dhënë nga gjykatat e rregullta tashmë është përfundimtar. Ish-AKM-ja në fazën e procedurës ankimore megjithatë ishte palë në procedurë, por ajo nuk ishte e suksesshme me ankesën e saj. Andaj, Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prizren tashmë është i formës së prerë dhe detyrues për palët e përfshira në procedurë.

(...)

Si rrjedhojë, raporti midis NSH-së dhe Agjencisë duhet të konsiderohet si i brendshëm. Agjencia dhe NSH-ja janë dy anët e së njëjtës monedhë. Prandaj, pjesëmarrja e njëres prej tyre në procedura gjyqësore është e mjaftueshme që të merret parasysh në përputhje me të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për gjykim të drejtë. Mungesa e Agjencisë për të intervenuar nuk e vë në dyshim plotfuqishmërinë e Aktgjykimit.

Aktgjykimi i plotfuqishëm për rastin kur vetëm NSH-ja ose Agjencia kanë qenë palë, është Aktgjykim detyrues për të dyja, si për NSH-në ashtu edhe për Agjencinë. Ky ka qenë edhe konkluzioni i gjykatës në disa aktgjykime tjera, qe do të thotë në aktgjykimet e datave 20.09.2012 (rasti SCPL-10-0001), 7.03.2013 (rasti AC-II-12-0212) dhe 28.06.2013 (rastet SCA-08-0040 dhe SCA-08-0038)."

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me Aktvendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DhPGJS-së, i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 3, 31, 46, 53, 54, 102.3, 103.7, 121 dhe 159 të Kushtetutës, për shkak se kolegji në fjalë, sipas parashtrueses së kërkesës, nuk e zbatoi në këtë rast nenin 4.4 të Rregullores nr. 2002/13 të 13 qershorit 2002, nenin 4, paragrafin 5, pikat 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-033 për DhPGJS-në, si dhe nenin 5, paragrafët 6 dhe 7.1 të Ligjit nr. 06/L-086 për DhPGJS-në, të shpallur në Gazetën Zyrtare më 27 qershor 2020.
26. Parashtruesja e kërkesës, në mbështetje të pretendimeve të saj, kërkesës ia ka bashkëngjitur disa vendime të nxjerra nga DhPGJS, siç janë: SCA-08-00S8, SCA-10-037, SCA-07-0030, ASC-09-0043, AC-II-15-0004, AC-II-14-0048, SCA-08-009, duke pretenduar se në këto raste Kolegji i Apelit i DhPGJS-së kishte anuluar vendimet e gjykatave të rregullta për shkak të juridiksionit lëndor.
27. Tutje, parashtruesja e kërkesës shton se: "Në arsyetimin e rastit ... SCA-10-037 të vitit 2013 lidhur me aktgjykimin e GJK në Lipjan, thuhet se kjo dispozitë me Ligj për Dhomën e Posaçme nr. 04/L-033, neni 4.5.1 vetëm se plotësohet më bindshëm edhe për faktin që DHP duhet me vepruar sipas detyrës zyrtare (në mënyrë vetanake). Sipas Aktvendimit AC-II-15-0004, dt. 16.01.2020 me të cilin anulohet aktgjykimi i GJK në Prishtinë-Dega në Graçanicë me C. nr. 206/08 dt 12.02.2009 në bazë të nenit 5. paragrafi 7, të ligjit nr.06/L-086 për DHP aktualisht në fuqi, nga data 01.01.2012, që domethënë se është zbatuar dispozita ligjore për të cilën i njëjti kolegji në aktvendimin e atakuar me kërkesë në Gjykatën Kushtetuese me AC-II-15-0042 dt 21.07.2020 në faqen nr. 5, në pasusin e parafundit, në rreshtin e 4 thuhet: "Kolegji i Apelit të DH së Posaçme vlerëson se neni 4.4 i ligjit nr. 06/L-086 për DHP aktualisht në fuqi, nga data 01.01.2012, nuk ka efekt retroaktiv ndaj aktgjykimeve dhe aktvendimeve të plotfuqishme të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji". Gjithashtu me Aktvendimin AC-II-14-0048 dt 29.11.2019 Kolegji i Apelit të DHPGJSK e ka anuluar Aktgjykimin e GJK në Prizren me C. nr. 879/97 dt 03.06.2011 duke u bazuar në të njëjtën dispozitë për të cilën ka theksuar se nuk ka efekt retroaktiv".
28. Mbi këtë bazë, parashtruesja e kërkesës mëton: "Përmes analizimit të këtyre rasteve vërehet dallimi i punës së DHP para 2009 dhe pas vitit 2009. Ndryshimi i praktikës së gjyimit të rasteve dhe mënyra e zbatimit të ligjeve në fuqi pa pasur kujdes për pasojat që i shkakton kjo qasje dhe për shkeljet e dispozitave ligjore etj. (...) Nga këto prova dhe shumë të tjera mund të vërehet praktika e Dhomës së Posaçme lidhur me juridiksionin e saj. Por lidhur me rastin për të cilin po parashtrojmë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, vërehet

se Dhoma e Posaçme nuk i është përmbajtur këtyre praktikave dhe dispozitave ligjore me ç'rast janë shkelur të drejtat e punëtorëve për realizimin e 20% nga asetit i Ndërmarrjes Bujqësore "Mirusha" në Malishevë si dhe dëmtimin e fondit prej 80% të dedikuar për kreditorët e mundshme dhe buxhetin e Kosovës dedikuar fondit për rimëkëmbjen ekonomike si funksion primar të AKP-së".

29. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata: të pranohet kërkesa si e bazuar, të prishet Aktvendimi i kontestuar i DhPGJS-së, të pranohet ankesa e AKM-së dhe AKP-së, të shpallën nul aktgjykimet e atakuara të gjykatave të rregullta, C. nr. 29/2007 dhe Ac. nr. 571/07, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje pranë DhPGJS-së në Prishtinë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
31. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

[...]

32. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton:

"4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme."

33. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se parashtruesja e kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë si për individët ashtu edhe për personat juridik për aq sa janë të zbatueshme (shih rastin e Gjykatës nr. KI118/18, me parashtrues: *Eco Construction sh.p.k.*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 tetorit 2019, paragrafi 29 dhe referencat e përdorura aty).

34. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç janë të përcaktuara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47

[Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesja e kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

35. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë, siç janë cekur më lart, Gjykata vlerëson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar për parashtrim të kërkesës në kuadër të neneve 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës dhe konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin AC-II-15-0042 të Kolegjit të Apelit të DhPGJS-së, të 21 korrikut 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.

36. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

37. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GjEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.

38. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si „qartazi e pabazuar“ dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të kualifikuara si „qartazi të pabazuara“, Udhëzuesin Praktik të GjEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 30 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita, A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 225 deri në 284).
39. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 3, 31, 46, 53, 54, 102.3, 103.7, 121 dhe 159 të Kushtetutës, për shkak se kolegji në fjalë nuk zbatoi nenin 4.4 të Rregullores nr. 2002/13 të 13 qershorit 2002, nenin 4, paragrafin 5, pikat 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr. 04/L-033 për DhPGjS dhe nenin 5, paragrafët 6 dhe 7.1 të Ligjit nr. 06/L-086 për DhPGjS-së, të shpallur në Gazetën Zyrtare më 27 qershor 2020.
40. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendon se vendimmarrja e DhPGjS-së që nga themelimi i saj, përkritazi me vlerësimin e juridiksionit lëndor, në rastet kur gjykatat e rregullta kanë vendosur për kontestet pronësore nuk është konsistente. Për më tepër, parashtruesja ankohet gjithashtu se nuk kishte dijeni për zhvillimin e procedurës civile pranë gjykatave të rregullta të cilat vendosën për vërtetimin e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese, ndërmjet Ismajl dhe Shpëtim Telakut dhe OPB Mirusha-Malishevë.
41. Nga sa u tha më sipër, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtrueses së kërkesës ka të bëjë kryesisht me të drejtën për gjykim të drejtë e cila mbrohet nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, andaj në këtë kuptim Gjykata do t’i shqyrtojë pretendimet e parashtrueses së kërkesës, i. përkritazi me zbatimin e gabuar të dispozitave të ligjit për DhPGjS, dhe ii. moskonsistencën në vendimmarrje, dhe mohimin e të drejtës për pjesëmarrje dhe mbrojtje efektive pranë gjykatave të rregullta, duke iu referuar nenit 53 të Kushtetutës, që përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

i. Përkritazi me pretendimin për zbatimin arbitrar të dispozitave të Ligjit për DhPGjS-në

42. Sa i përket këtij pretendimi të parashtrueses së kërkesës se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, shkeli të drejtat e saj të garantuara me nenet e sipërcekura të Kushtetutës, sepse nuk zbatoi dispozitat përkatëse të Ligjit për DhPGjS-në, Gjykata konsideron se një pretendim i tillë ngritë çështje të ligjshmërisë dhe jo

të kushtetutshmërisë. Gjykata në mënyrë të përsëritur ka theksuar se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin dhe zbatimin e gabuar të dispozitave të ligjit, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund t'i shqyrtojë ato (shih, në këtë kontekst dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtrues i kërkesës: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport SH.A., "Adem Jashari"*, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtrues i kërkesës: Gani Gashi, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtrues i kërkesës: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

43. Në mënyrë konsistente, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës KI128/18, i cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, i cituar më lart, paragrafi 58)).
44. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (shih rastin e GjEDNj-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 62).
45. Megjithatë, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GjEDNj-ja ka theksuar se përderisa autoritet vendore kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të legjislacionit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNj-në (shih rastin e GjEDNj-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
46. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka "*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*" në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në "*konkluzione arbitrare*" apo "*qartazi të paarsyeshme*" për parashtruesin e kërkesës (përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).

47. Në këtë aspekt, Gjykata duhet të theksojë se parashtruesja e kërkesës nuk ka argumentuar para Gjykatës (i) arsyet të cilat do të mund të mbështesin pretendimin se në rrethanat e rastit konkret, nenet përkatëse të Ligjit për DhPGjS-në, janë interpretuar nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së në “*mënyrë qartazi të gabuar*”; dhe (ii) se si një interpretim i tillë, ka rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesen e kërkesës.
48. Gjykata në këtë këndvështrim, vëren se pretendimet e parashtrueses së kërkesës përkitazi me aplikimin e gabuar të dispozitave të lartcekura të ligjeve për DhPGjS-në, janë adresuar dhe arsyetuar nga Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, duke dhënë arsyeime të detajuara për refuzimin e secilit prej pretendimeve të ngritura nga parashtruesja e kërkesës (shih, për më tepër, arsyetimin e Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, në paragrafin 20 të këtij dokumenti).
49. Gjykata gjithashtu thekson faktin se në vlerësimin e pretendimeve “të shkallës së katërt” e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së, ajo gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Ky koncept kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të kësaj procedure, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë (shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GjEDNj-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafi 264 dhe referencat e përmendura aty). Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë së një procedure në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GjEDNj-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo* kundër Spanjës, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës: *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
50. Më tej dhe në fund, Gjykata thekson se neni 6 i KEDNj-së, në një proces gjyqësor, nuk i garanton askujt rezultat të favorshëm, sepse njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI118/17, *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 36; dhe KI142/15, parashtrues *Habib Makiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 1 nëntorit 2016, paragrafi 43).
51. Nga sa u tha më sipër, Gjykata konstaton se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së ka respektuar kërkesat e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së, duke i dhënë mundësi parashtrueses së kërkesës, si dhe palëve të tjera në procedurë, që t’i paraqesin kundërshtimet e tyre përkitazi me çështjen juridike të

parashtruar pranë DhPGJS-së. Për më tepër, të gjitha argumentet, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të parashtrueses së kërkesës janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga kolegji në fjalë; arsyet faktike e ligjore ndaj aktvendimit të kontestuar janë shtruar dhe arsyetuar hollësisht, si dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk ishin të padrejta.

52. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk ka asgjë që tregon se Kolegji i Apelit i DhPGJS-së, ka *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”*, aplikim i cili do të mund të rezultonte në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesen e kërkesës.
53. Prandaj, pretendimet e parashtrueses së kërkesës për vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “ligjshmërisë”, dhe nuk janë argumentuar në nivel të “kushtetutshmërisë”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

ii. Përkitazi me moskonsistencën në vendimmarrje

Parimet e përgjithshme

54. Përkitazi me parimet themelore që ndërlidhen me konsistencën e praktikës gjyqësore, Gjykata rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNJ-së ka rezultuar në katër parime themelore që e karakterizojnë analizën lidhur me konsistencën e praktikës gjyqësore, dhe atë si në vijim: (i) siguria juridike; (ii) nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore; (iii) divergjenca nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNJ-në; dhe (iv) përjashtimi i arbitraritetit të dukshëm.
55. Lidhur me parimin e parë, GjEDNJ është përqendruar në parimin e sigurisë juridike e që në këtë kontekst është e mishëruar në të gjitha nenet e KEDNJ-së dhe përbën një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit (shih rastin e GjEDNJ-së, *Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56). Ky parim garanton një stabilitet të caktuar në situata ligjore dhe kontribuon në besimin e publikut në gjykata. Vazhdimësia e divergjencës në praktikë gjyqësore mund të krijojë situata të pasigurisë juridike duke rezultuar në ulje të besimit të publikut në sistemin gjyqësor, ndërsa ky besim është qartazi njëri nga komponentët thelbësor të shtetit që bazohet në sundim të ligjit (shih, në këtë kontekst rastin e GjEDNJ-së *Hayati Çelebi dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; dhe *Ferreira Santos Pardal kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 30 korrikut 2015, paragrafi 42; shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/2017, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 25 janarit 2018, paragrafi 33).
56. Lidhur me parimin e dytë, GjEDNJ ka konstatuar se kërkesat e sigurisë juridike dhe të mbrojtjes së besimit legjitim të publikut, megjithatë nuk garantojnë një të drejtë të fituar në konsistencë të praktikës gjyqësore. Zhvillimi i praktikës gjyqësore nuk është, në vetvete, në kundërshtim me administrimin e drejtë të drejtësisë pasi që mosruajtja e një qasje dinamike dhe evolutive, do të

rrezikonte të pengojë reformën ose përmirësimin e vazhdueshëm (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNJ-së, *Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafin 58; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 29 nëntorit 2016, paragrafi 116; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/17, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 34).

57. Lidhur me parimin e tretë, GjEDNJ ka konstatuar se mundësia e vendimeve kontradiktore gjyqësore është një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor i cili bazohet në një rrjet të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit me autoritet mbi fushën e juridiksionit territorial të tyre. Divergjencat e tilla mund të paraqiten gjithashtu brenda të së njëjtës gjykatë. Kjo, në vetvete, nuk mund të konsiderohet në kundërshtim me KEDNJ-në (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 51; *Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë* dhe 63 (gjashtëdhjetë e tri) kërkesa tjera, Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafi 34; *Santo Pinto kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 20 majit 2008, paragrafi 41; dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 122; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/17, me parashtrues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 35).
58. E fundit dhe në lidhje me parimin e katërt, GjEDNJ ka theksuar vazhdimisht se, përveç rasteve të arbitraritetit të dukshëm, nuk është detyrë e saj të vë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendas nga ana e gjykatave vendore (shih, për shembull, rastet e GjEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, Aktgjykim i 24 qershorit 2008, paragrafi 118; dhe *Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 50) dhe në parim, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër, GjEDNJ-ja ka theksuar se nuk mund të konsiderohet të ketë divergjencë në praktikën gjyqësore kur gjendjet faktike të çështjes janë objektivisht të ndryshme (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNJ-së *Uçar kundër Turqisë*, Vendim i 29 shtatorit 2009). Njëlloj, trajtimi i dy kontesteve në mënyrë të ndryshme nuk mund të konsiderohet se krijon praktikë gjyqësore divergjente kur kjo arsyetohet nga një ndryshim në gjendjet faktike në fjalë (shih, rastet e GjEDNJ-së, *Hayati Çelebi dhe të tjerët*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016, paragrafi 52; si dhe *Famullia Katolike Greeke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 116).
59. Gjithashtu, Gjykata vëren se qasja e GjEDNJ-së në analizimin e divergjencave në praktikën gjyqësore, ndryshon në varësi të faktit nëse (i) divergjencat ekzistojnë brenda të njëjtës degë të gjykatave; ose (ii) ndërmjet dy degëve të ndryshme të gjykatave të cilat janë plotësisht të pavarura nga njëra-tjetra. Situata e dytë ka të bëjë me sistemet gjyqësore që përbëhen nga më shumë se një degë e sistemit gjyqësor, secila me gjykatën përkatëse e të pavarur supreme e që nuk i nënshtrohet ndonjë hierarkie të përbashkët gjyqësore. Rasti kryesor i GjEDNJ-së lidhur me mungesën e konsistencës, përkatësisht divergjencën e praktikës gjyqësore, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, bie brenda kësaj kategorie. Sidoqoftë, parimet themelore të vendosura përmes këtij rasti, përdoren gjithashtu në vlerësimin e divergjencave që kanë të bëjnë me praktikën gjyqësore edhe në rastet që i përkasin kategorisë së parë,

përkatësisht, atyre me një sistem unik gjyqësor, që do të ishte rasti në kontekst të sistemit juridik të Republikës së Kosovës.

60. Duke iu referuar parimeve të përcaktuara më lart, Gjykata më tej thekson se GjEDNj-ja përdor tri kriterë themelore për të përcaktuar nëse një divergjencë e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, si në vijim: (i) nëse divergjencat në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjenca të tilla; dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GjEDNj-së, *Beian kundër Rumanisë* (nr.1), Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37 -39; *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafët 116 - 135; *Iordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; *Nejdet Şahin i Perihan Şahin kundër Turqisë*, cituar më lart, paragrafi 53; dhe *Hayati Çelebi dhe të tjerët*, cituar më lart, paragrafi 52; dhe shih gjithashtu rastin e Gjykatës, KI42/17, me parashtues *Kushtrim Ibraj*, cituar më lart, paragrafi 39).
61. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu rithekson se nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme. Ajo duhet të respektojë pavarësinë e gjykatave. Për më tepër që në raste të tilla, përkatësisht pretendimeve për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, parashtuesit e kërkesave duhet t'i paraqesin Gjykatës argumente përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar kështu në divergjencë në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNj-së.

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rrethanat e rastit konkret

62. Gjykata rikujton se parashtuesja e kërkesës pretendon se në rastin e saj, DhPGJS-ja ka vendosur ndryshe përkitazi me juridiksionin lëndor, duke vepruar në kundërshtim me praktikën e saj gjyqësore. Në këtë kontekst, parashtuesja e kërkesës i referohet dy periudhave kohore, asaj para vitit 2009 dhe pas vitit 2009, vetëm përkitazi me aplikimin e ligjit në fuqi, duke theksuar se: “*Përmes analizimit të këtyre rasteve vërehet dallimi i punës së DHP para 2009 dhe pas vitit 2009. Ndryshimi i praktikës së gjykimit të rasteve dhe mënyra e zbatimit të ligjeve në fuqi pa pasur kujdes për pasojat që i shkakton kjo qasje dhe për shkeljet e dispozitave ligjore etj. (...) Nga këto prova dhe shumë të tjera mund të vërehet praktika e Dhomës së Posaçme lidhur me juridiksionin e saj. Tutje, parashtuesja e kërkesës shton se, “...lidhur me rastin për të cilin po parashtrojmë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, vërehet se Dhoma e Posaçme nuk i është përmbajtur këtyre praktikave dhe dispozitave ligjore me ç'rast janë shkelur të drejtat e punëtorëve për realizimin e 20% nga asetit i Ndërmarrjes Bujqësore “Mirusha” në Malishevë si dhe dëmtimin e fondit prej 80% të dedikuar për kreditorët e mundshëm dhe*

buxhetin e Kosovës dedikuar fondit për rimëkëmbjen ekonomike si funksion primar të AKP-së”.

63. Gjykata thekson se ajo vlerëson konsistencën e praktikës gjyqësore të Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së vetëm në raport me shkeljet e pretenduara nga parashtruesja e kërkesës. Rrjedhimisht, mungesa e konsistencës në praktikën gjyqësore duhet të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të parashtrueses së kërkesës. Për të konstatuar një shkelje të tillë, dhe për të konstatuar se të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses së kërkesës janë shkelur si rezultat i *“dallimeve të thella dhe të afatgjata”* në praktikën përkatëse gjyqësore, rrethanat faktike dhe juridike të rastit të parashtrueses së kërkesës duhet të jenë tërësisht identike me ato raste të cilave iu referohet e njëjta.
64. Në mbështetje të pretendimeve të saj, parashtruesja e kërkesës ia bashkëngjiti vendimet e DhPGjS-së: [SCA-07-0030], [SCA-08-0058], [ASC-09-0043], [SCA-10-0037], [AC-II-14-0043] dhe [AC-II-15-0004], duke theksuar se në këto raste DhPGjS-ja kishte anuluar, prishur dhe shpallur të pavlefshme vendimet e gjykatave të rregullta për shkak të mungesës së juridiksionit lëndor. Duke iu referuar vendimeve në fjalë Gjykata verën se:

-Vendimi [SCA-07-0030] i DhPGjS-së, ka prishë Aktgjykimin [C.nr.47/3007] e Gjykatës Komunale në Mitrovicë dhe Aktgjykimin [AC.nr.195/2007] të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, ku objekti i çështjes ishte vërtetimi i pronësisë. Në këtë rast, *“Dhoma ia përcjellë këtë lëndë Gjykatës komunale të Mitrovicës së cilës ia bart juridiksionin për vendosje.”* (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

-Vendimi [SCA-08-0058] i DhPGjS-së, ka abroguar Aktgjykimin [C.nr.26/2008] e Gjykatës Komunale në Podujevë, ku objekti i çështjes ishte kontrata e shitblerjes së një ngastre kadastrale. Në këtë rast, lënda i ishte kthyer serish për rigjykim Gjykatës Komunale në Podujevë (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

-Vendimi [ASC-09-0043] i DhPGjS-së, ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimin [C.nr.450/2004] e Gjykatës Komunale në Prizren dhe Aktvendimin [Ac.nr.281/2005] e Gjykatës së Qarkut në Prizren, ku objekti i çështjes ishte vërtetimi i marrëdhënies së punës dhe kompensimi i pagave të papaguara. Në këtë rast, lënda i ishte dërguar për rigjykim shkallës së parë të DhPGjS-së (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

-Vendimi [SCA-10-0037] i DhPGjS-së, ka shpallur të pavlefshëm Aktgjykimet [C.nr.74/2005] dhe [C.nr.282/2005] të Gjykatës Komunale në Lipjan, ku objekt i çështjes ishte kthimi i punëtoreve në punë dhe kompensimi i pagave të papaguara. Në këtë rast lënda i ishte kthyer për rigjykim Gjykatës Themelore në Prishtinë-dega në Lipjan (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

-Vendimi [AC-II-14-0048] i DhPGjS-së, ka anuluar Aktgjykimin [C.nr.879/97] të Gjykatës Komunale në Prizren, ku objekti i çështjes ishte

anulimi i kontratës së shitblerjes së një ngastre kadastrale. Edhe në këtë rast, lënda i ishte dërguar për rigjykim shkallës së parë të DhPGjS (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

-Vendimi [AC-II-15-0004] i DhPGjS-së, ka anuluar Aktgjykimin [C.nr206/08] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, ku objekti i çështjes ishte pagesa e pagave të papaguara dhe në këtë rast lënda i ishte dërguar për rigjykim shkallës së parë të DhPGjS (nënkupton se çështja nuk kishte përfunduar);

65. Nga referimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesja e kërkesës nuk ka arritur të argumentojë se *“dallimet e thella dhe afatgjata”* në praktikën gjyqësore të DhPGjS-së, përveç rrethanave juridike janë tërësisht identike edhe për nga rrethanat faktike me rastet të cilave iu është referuar. Në këtë kontekst Gjykata thekson se nuk mund të ndërtohet një pretendim për moskonsistencë në vendimmarrje, vetëm mbi bazën e ngjashmërive e rastit për nga rrethanat juridike, përkatësisht mbi bazën e zbatimit të të njëjtave dispozita ligjore të ligjit të DhPGjS-së dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore.
66. Përveç kësaj, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vënë theks në faktin se divergjenca në praktikën gjyqësore jodetyrimsht është në kundërshtim me KEDNj-në, sepse qasja dinamike dhe evolutive e gjykatave në interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe për më tepër, zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë.
67. Gjykata nuk e mohon faktin se edhe mund të këtë pasur kundërthënie në praktikën gjyqësore të DhPGjS-së, megjithatë është tejet e rëndësishme të merret parasysh fakti nëse ato kundërthënie janë rezultat i dinamikës së përmirësimit të administrimit të drejtësisë, vendimmarrjes dhe pajtueshmërisë me konventat ndërkombëtare dhe me Kushtetutën, e cila ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008, çfarë nënkupton se KEDNj tashmë është pjesë e rendit juridik të brendshëm në Republikën e Kosovës dhe ka epërsi ndaj ligjeve vendore, kur është në pyetje interpretimi i të drejtave të njeriut, ku hyjnë personat fizik dhe juridik siç është parashtruesja e kërkesës.
68. Gjykata, dëshiron të rikujtojë gjithashtu faktin se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, në lidhje me rastin e parashtruesës së kërkesës i ka kushtuar kujdes të veçantë parimit të sigurisë juridike për çështjet e gjykuara *res judicata*. Në këtë kontekst, Aktvendimi i kontestuar thekson: *“Përkundër faktit se AKP-ja, në ankesën e vetë para DHPGJS-së e ka ngritur çështjen e mungesës së juridiksionit të gjykatave të rregullta për nxjerrjen e aktgjykimeve të ankmuara, kur objekti i kontestit përfshihet në juridiksionin e DHPGJS-së (neni 4), dhe palë e paditur është Ndërmarrja Shoqërore (neni 5), Kolegji i Apelit vlerëson se neni 4.4 i Ligjit për Dhomën e Posaçme (LDHP-së) i cili ka hyrë në fuqi më 01.01.2012, nuk ka efekte retroaktive ndaj aktgjykimeve apo aktvendimeve të plotfuqishme të lëshuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji. Kjo situatë ligjore e cekur, ngjashëm është rregulluar edhe me nenin 5.4 të LDHP-së nr. 06/L-086, i cili ligj tashmë është në zbatim. Rasti në fjalë është*

i tillë. Prandaj si është vendosur tani më, nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit (AC-II-14-0015) këtë ankesë duhet hedhur poshtë si të papranueshme”.

69. Tutje, Kolegji i Apelit të DhPGjS-së, arsyetoi se, “Aktgjykimet dhe aktvendimet e formës së prerë të nxjerra para hyrjes në fuqi të nenit 4.5.1. e LDHP-së, të vitit 2012, nuk duhet të konsiderohen nule dhe pa efekte juridike, edhe nëse janë nxjerrë për rastet që bien në kompetencë të Dhomës së Posaçme. Zgjidhje të njëjtë parasheh edhe Ligji i ri nr. 06/L-086 në zbatim nga data 17 korrik 2019”. Në këtë këndvështrim, Gjykata rikujton se nuk duhet harruar fakti se gjykatat gjykojnë rast pas rasti bazuar në specifikat, rrethanat faktike dhe juridike të rasteve, për të arritur më pas në një konkluzion ku vendimmarrja e tyre të jetë në pajtueshmëri me të drejtën për gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së.
70. Për më tepër, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, në rastin konkret ka zbatuar nenin 6.1 të KEDNj-së, duke u thirrur në mbrojtje të çështjes së gjykuar (*res judicata*), ku theksohet se: “Lidhur me pyetjen e vendimeve të nxjerra nga gjykatat kompetente, sistemet ligjore në përgjithësi përgjigjen duke u thirrur në parimin e sigurisë ligjore me vërtetim të plotfuqishmërisë së Aktgjykimit (“*res judicata*”), që mbulon dhe rregullon të gjitha format e parregullsive të shkaktuara si pasojë e mungesës së juridiksionit”.
71. Më tej, Kolegji i Apelit i DhPGjS-së arsyeton se, “Edhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka inkorporuar këtë arsyetim në koncept të së drejtës për gjykim të drejtë. Në Aktgjykimin e rastit XHERAJ v. ALBANIA (Kërkesa nr. 37959), e datës 29.07.2008, thuhet si ne vijim: “Gjykata rithekson se në përputhje me preambulën e Konventës, sundimi i ligjit është pjesë e trashëgimisë së përbashkët e Shteteve Kontraktuese, një nga aspektet themelore e së cilës është parimi i sigurisë juridike, që ndër të tjerash kërkon se kur gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, aktvendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje (shih *Brumarescu v. Rumania* [GC], nr. 28342/95, § 61, ECHR 1999 VII)”.
72. Gjykata, tutje rikujton se e drejta për “gjykim të drejtë” kërkon që një çështje që është bërë *res judicata* të konsiderohet e pakthyeshme, në pajtim me parimin e sigurisë juridike (shih rastin e GjEDNj-së, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61; shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI122/17, parashtrues: *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, dhe rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87, shih gjithashtu rastin KI127/19, parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendim i 13 majit 2020, paragrafi 42).
73. GjEDNj, në lidhje me rëndësinë e respektimit të parimit të sigurisë juridike konstatoi se “një nga aspektet themelore të shtetit ligjor është parimi i sigurisë juridike, i cili kërkon ndër të tjera se aty ku gjykatat kanë vendosur përfundimisht një çështje, vendimi i tyre nuk duhet të vihet në pikëpyetje” (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GjEDNj, *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 61, shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI89/13, parashtruese: *Arbresha*

Januzi, Aktgjykim i 12 marsit 2014, paragrafi 83, KI122/17, parashtrues: *Česká Exportní Banka A.S.*, Aktgjykim i 30 prillit 2018, paragrafi 149, rastin KI67/16, parashtruese: *Lumturije Voca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2017, paragrafi 87, dhe rastin KI94/13, parashtrues: *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014, shih gjithashtu rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendim i 13 majit 2020, paragrafi 43).

74. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se praktika e saj gjyqësore si dhe praktika gjyqësore e GjEDNj-së e përmendur më sipër, qartë dhe në mënyrë eksplicite, theksojnë se e drejta për gjykim të drejtë, sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së, përfshin parimin e sigurisë juridike, i cili parim thekson që vendimet gjyqësore përfundimtare të cilat janë bërë *res judicata* duhet të respektohen dhe nuk mund të rihapen ose të bëhen objekt i ankesave (shih rastin KI127/19, parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendim i 13 majit 2020, paragrafi 44).
75. Rrjedhimisht, në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe GjEDNj-së është theksuar se njëri nga aspektet themelore të sundimit të ligjit është parimi i sigurisë juridike, i cili presupozon *respektimin e vendimeve të formës së prerë, res judicata* (shih rastin *Brumarescu kundër Rumanisë*, kërkesa nr. 28342/95, Aktgjykim i 28 tetorit 1999, paragrafi 62). Sipas GjEDNj-së “asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një vendimi të plotfuqishëm dhe detyrues gjyqësor thjesht për qëllim të fitimit të rishqyrtimit dhe zgjidhjes së freskët të rastit (shih, ndër të tjera, rastet e GjEDNj-së *Ryabykh kundër Rusisë*, nr. 52854/99, GJEDNJ, Aktgjykimi i 24 korrikut 2003, paragrafi 52, dhe *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 48553/99, paragrafi 72; shih, gjithashtu, rastet e Gjykatës, rastin nr. KI55/18, parashtrues *Fatmir Pirreci*, Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim i 16 korrikut 2012, par. 42 dhe rastin nr. KI94/13, parashtrues *Avni Doli, Mustafa Doli, Zija Doli dhe Xhemile Osmanaj*, Aktgjykim i 14 prillit 2014, shih po ashtu rastin KI127/19 parashtrues: *Benazir Berisha*, Aktvendim i 13 majit 2020, paragrafi 45).
76. Nga shtjellimet e mësipërme, Gjykata gjeti se korniza ligjore e DhPGJS-së gjatë viteve ka pësuar ndryshime të cilat kanë ishin rezultat i evoluimit dhe dinamikës së përmirësimit të administrimit të drejtësisë, vendimmarrjes dhe pajtueshmërisë me kërkesat e KEDNj-së dhe Kushtetutës (shih me sipër paragrafin 66 të këtij dokumenti, ku theksohet se “...divergjenca në praktikën gjyqësore jodetyrimit është në kundërshtim me KEDNj-në, sepse qasja dinamike dhe evolutive e gjykatave në interpretimin e ligjit të aplikueshëm dhe për më tepër, zhvillimi i praktikës gjyqësore është i rëndësishëm për të mbajtur dinamikën e duhur të përmirësimit të vazhdueshëm të administrimit të drejtësisë.”).
77. Përveç kësaj, në dritën e rrethanave të rastit konkret, Gjykata gjeti se nuk u vërtetua as ekzistenca e ngjashmërive të rrethanave faktike të rasti konkret, me rastet të cilave parashtruesja e kërkesës iu është referuar. Ndër të tjera, Gjykata vërejtë se edhe mes vetë rasteve të referuara nuk ka ngjashmëri për nga rrethanat faktike të çështjes.

78. Për me tepër, Gjykata vërejtë se Kolegjet i Apelit i DhPGjS-së ka vepruar në pajtueshmëri me praktikën e vetë gjyqësore, dhe kjo mund të vërehet nga arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar i Kolegji i Apelit i DhPGjS-së, ku mes tjerash theksohet: *“Ky ka qenë edhe konkluzioni i gjykatës në disa aktgjykime tjera, që do të thotë në aktgjykimet e datave 20.09.2012 (rasti SCPL-10-0001), 7.03.2013 (rasti AC-II-12-0212) dhe 28.06.2013 (rastet SCA-08-0040 dhe SCA-08-0038)”*.
79. Andaj Gjykata, konsideron se kërkesa e parashtrueses se kërkesës, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar mjaftueshëm dhe në mënyrë bindëse pretendimin e saj për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për shkak të moskonsistencës së praktikës gjyqësore.

iii. Përkitazi me pretendimet për shkelje të neneve 3, 46, 54, 102, 103, 121 dhe 156 të Kushtetutës

80. Sa i përket shkeljeve të mësipërme të të drejtave të garantuara me nenet 3, 46, 54, 102, 103, 121 dhe 156 të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të vendosur mirë të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:
- a) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (Vendim)* nr. 4241/03, të 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin *Baillard kundër Francës (Vendim)* nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi/ja i/e kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe.
81. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës pretendon se aktvendimi i kontestuar i Kolegjit të Apelit të DhPGjS-së, po ashtu shkel të drejtat e saj të garantuara me nenet 3, 46, 54, 102, 103, 121 dhe 156 të Kushtetutës. Në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës vetëm i përmend nenet respektive, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të

tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës Kushtetuese KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, paragrafi 33; KI187/18 dhe KI 11/19, parashtrues: *Muhamet Idrizi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2019, paragrafi 73, dhe së fundmi rastin KI125/19 parashtrues: *Ismajl Bajgora*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 63). Andaj, në lidhje me këto pretendime, Gjykata në përputhje me praktikën e saj kërkesën e parashtrueses së kërkesës e deklaroi qartazi të pabazuar dhe rrjedhimisht të papranueshme.

82. Prandaj, Gjykata konstaton se përkitazi me këto pretendime të parashtrueses së kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 3, 46, 54, 102, 103, 121 dhe 156 të Kushtetutës, Gjykata konkludon që kjo pjesë e kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i përkasin kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyeshme”, sepse parashtruesja e kërkesës thjesht citoi një ose më shumë dispozita të Konventës ose të Kushtetutës, pa shpjeguar se si ato ishin shkelur. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

83. Si përmbledhje, Gjykata duke u mbështetur në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton që parashtruesja e kërkesës në asnjë mënyrë nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e saj, për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ, respektivisht me nenet e sipërcekura.
84. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa në tërësi duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar sepse këto pretendime të parashtrueses së kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë (i) pretendime të “shkallës së katërt” dhe kategorinë (iii) pretendime “të pambështetura ose të paarsyetuara”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Kërkesa për seancë dëgjimore

85. Gjykata gjithashtu rikujton se parashtruesja e kërkesës ka kërkuar mbajtjen e seancës dëgjimore. Gjykata rikujton se rregulli 42 [E drejta në dëgjim dhe heqja dorë] paragrafi (2) i Rregullores së punës përcakton që “Gjykata mund të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo ligjit”.
86. Gjykata vëren se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës është i karakterit diskrecional. Si i tillë, ky rregull vetëm parasheh mundësinë që Gjykata të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rastet kur beson se ajo është e nevojshme për të qartësuar çështje të provave apo të ligjit. Pra, Gjykata nuk është e obliguar të urdhërojë mbajtjen e seancës dëgjimore në rast se ajo

konsideron se të dhënat ekzistuese në shkresat e lëndës mjaftojnë, përtej çdo dyshimi, për të arritur tek një vendim meritohet lidhur me rastin që është në shqyrtim (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI34/17, parashtruese *Valdete Daka*, Aktgjykim i 1 qershorit 2017, paragrafët 108-110 - ku thuhet se “*Gjykata konsideron se dokumentet e përfshira në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur në rast [...]*”).

87. Gjykata, sapo konstatoi se të gjitha pretendimet e parashtrueses së kërkesë për shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, janë qartazi të pabazuara, andaj në dritën e kësaj nuk e konsideron të nevojshme të mbajë seance dëgjimore, pasi që dokumentet e bashkëngjitura në kërkesë janë të mjaftueshme për të vendosur për kërkesën e parashtrueses së kërkesës. Rrjedhimisht, Gjykata, njëzëri, e refuzon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për caktim të seancës dëgjimore si të pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 113.7 dhe 21.4 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 26 mars 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË njëzëri kërkesën e parashtrueses për mbajtje të seancës dëgjimore;
- III. T’UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi